EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8416
E enjte, 22 tetor 2026
Çmimi 0. 50 €

Garantim i rendit apo tejkalim i forcës? Pretendimet për ndërhyrjet e policisë në protesta

FAQE 7

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HAMZA JEP DORËHEQJE NGA POZITA E KRYETARIT TË PDK-së

FAQE 5

- Nuk po largohem nga PDK-ja, por vetëm nga pozita e kryetarit

Bedri Hamza ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Në një konferencë për medie mbajtur të mërkurën, ai ka thënë se ky vendim i hapë rrugë një procesi të ri zgjedhor brenda PDK-së, përmes të cilit anëtarët do të vendosin për drejtimin e ardhshëm të partisë. Hamza ka theksuar se përgjegjësitë që ka marrë nga viti 2020, pas dërgimit në Hagë të ish-udhëheqësve të PDK-së, përfshirë kandidimin për kryetar të Mitrovicës, kandidimin tri herë radhazi për kryeministër dhe udhëheqjen e partisë, i ka marrë për shkak të përgjegjësisë ndaj PDK-së e Kosovës dhe jo nga ambiciet personale. Megjithatë, ai ka thënë se kjo nuk do të thotë se do të largohet nga PDK-ja. "Po largohem vetëm nga pozita e kryetarit, por jo edhe nga besimi në vlerat tona politike", është shprehur ai

SEANCA E KËSHILLIT TË SIGURIMIT PËR KOSOVËN, ÇFARË THANË KONJUFCA, PËRFAQËSUESJA E SHBA-së DHE E MBRETËRISË SË BASHKUAR? F. 3

KOMISIONI PËR BUXHET NUK E MBËSHTET NDARJEN E NJË MILION EUROVE PËR PROTEZAT E INVALIDËVE TË LUFTËS, PESË DEPUTETË TË LV-së ABSTENUAN F. 7

AKTUALE

KURTI TAKOHET ME AMBASADORËT E BE-së, RIKONFIRMOHET MBËSHTETJA PËR INTEGRIMIN EVROPIAN TË KOSOVËS F. 6

BE-ja MBËSHTET LUFTËN KUNDËR DEZINFORMIMIT TË NXITUR NGA INTELIGJENCA ARTIFICIALE F. 3

ENERGJIA E SË ARDHMES: SA AFËR JANË QYTETARËT ME MUNDËSITË QË OFRON LIGJI? F. 5

EKONOMI

ÇFARË U KUSHTON QYTETARËVE NGECJA E INVESTIMEVE KAPITALE? F. 8

DITA E GRUAS RURALE, MUJA: VETËM 5 PËR QIND E PRONAVE NË KOSOVË JANË NË PRONËSI TË GRAVE F. 8

SPORT

"DARDANET" AVANCOJNË NË RANGLISTËN E FIFA-s F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

GARANTIM I RENDIT APO TEJKALIM I FORCËS? PRETENDIMET PËR NDËRHYRJET E POLICISË NË PROTESTA

TIRANË, 21 TETOR - Pretendimet për përdorim joproporcional të forcës nga policia ndaj pjesëmarrësve në protestat kundër qeverisë në Tiranë kanë nxitur reagime nga organizatat e shoqërisë civile dhe ato për mbrojtjen e gazetarëve. Këto organizata kanë raportuar për goditje me shkopinj gome dhe shkelma, lëndime të rënda dhe vonesa në dhënien e ndihmës mjekësore. Raportimet përfshijnë edhe raste të dyshuara të keqtrajtimit të të miturve, ndalime nga persona me rroba civile, dhunë ndaj gazetarëve, shkelje të të drejtave të personave të shoqëruar ose të ndaluar dhe përdorim të municioneve apo mjeteve të paidentifikuara.

Organizatat kanë kërkuar hetimin e rasteve të raportuara dhe sqarimin e përgjegjësive individuale e institucionale. Këto raportime vijnë pas disa ditësh përplasjesh mes protestuesve dhe policisë në Tiranë, që nga nisja e tyre më 13 tetor. Protestuesit, që po kërkojnë kushte më të mira në arsim, si kërkesë kryesore tani kanë dorëheqjen e kryeministrit shqiptar, Edi Rama.

Pamjet tregojnë dhunë të protestuesve ndaj policisë dhe dëmtime të objekteve publike, por edhe përdorimin e forcës nga policia, përfshirë së fundi plumbat e gomës.

Sipas Ministrisë së Shëndetësisë të Shqipërisë, deri më 19 tetor janë lënduar 310 persona: 191 policë, 88 protestues dhe 31 kalimtarë.

Ndërsa këto organizata kërkojnë hetimin e dhjetëra rasteve të raportuara për përdorim të dhunës nga policia, qeveria ka vendosur të shpërblejë me nga 2 500 euro rreth tre mijë punonjës policie, për atë që e cilëson si angazhim të shtuar në garantimin e rendit dhe sigurisë publike.

Vendimi u miratua mbrëmjen e 19 tetorit. Sipas tij, fondi prej 8.12 milionë eurosh do të mbulohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

Rama mbron policinë, institucionet hetojnë ndërhyrjet e saj

Teksa organizatat kërkojnë hetimin e dhunës së përdorur nga policia, kryeministri Edi Rama ka vënë theksin te dhuna e ushtruar nga protestuesit ndaj policisë. Në disa dalje publike ai është shfaqur me një gur në dorë, të cilin e ka paraqitur si simbol të dhunës ndaj policëve dhe e ka cilësuar si armë krimi.

Rama shprehu mirënjohje dhe respekt për punonjësit dhe drejtuesit e Policisë së Shtetit, duke deklaruar se ata po përballen "me dinjitet, me forcë, me kurajë" me atë që e quajti "valë dhune të protestuesve".

Rama paralajmëroi se studentët që, sipas tij, kanë ushtruar dhunë ndaj policisë, nuk do të përfitojnë bursa apo mbështetje financiare nga shteti dhe se mund të humbasin të drejtën për arsim falas. Ai tha se do të merren masa ndaj mësuesve që, sipas tij, kanë nxitur nxënësit të marrin pjesë në protesta të dhunshme, duke deklaruar se këta të fundit nuk do të vazhdojnë të punojnë si mësues apo punonjës të shtetit.

Në deklaratat e tij, ai nuk iu përgjigj drejtpërdrejt pretendimeve të organizatave për përdorim joproporcional të forcës ndaj protestuesve dhe gazetarëve.

Deri më tani Policia e Shtetit ka pezulluar shtatë punonjës, përfshirë një shef rendi, ndërsa Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (AMP) ka nisur verifikimet për dyshimet për përdorim të paligjshëm të forcës gjatë protestave.

Avokati i Popullit po heton dyshimet për përdorim joproporcional të forcës dhe shkelje të të drejtave të personave të shoqëruar gjatë protestave.

Më 20 tetor institucioni njoftoi se gjatë monitorimit të një dite më parë kishte kontaktuar 193 persona në polici dhe spital dhe kishte administruar 11 ankesa. Pesë të mitur në Komisariatin nr. 1 në Tiranë pretenduan dhunë fizike dhe verbale nga policia; te dy prej tyre, ekipet e monitorimit konstatuan shenja dëmtimi fizik. Gjetjet paraprake përfshijnë edhe mangësi në garantimin e të drejtave të të miturve, pretendime për kontrolle të telefonave pa bazë ligjore dhe mbingarkesë të ambienteve të ndalimit. Institucioni dënoi çdo akt dhune dhe kërkoi që policia ta përdorë forcën vetëm kur është e domosdoshme dhe në mënyrë proporcionale.

Rastet që kanë ngritur dyshime për tejkalim të forcës

Një nga episodet që ka tërhequr më shumë vëmendje është ai i një 21-vjeçari, pamjet e të cilit u shpërndanë gjerësisht në rrjetet sociale pas protestës së 16 tetorit në Tiranë. Sipas pamjeve të publikuara, një punonjës policie e shtyn të riun me mburojë dhe e rrëzon në tokë. Më pas, polici e godet me shkelm, ndërsa disa punonjës të tjerë e rrethojnë. Në pamje shihet gjithashtu një tjetër polic duke e goditur të riun, i cili

qëndron i shtrirë në tokë, pa lëvizur, ndërsa më pas tërhiqet zvarrë.

Motra e 21-vjeçarit, Ester Skana, i tha Radios Evropa e Lirë (REL) se vëllai i saj u mbajt për rreth katër orë në Komisariatin e Policisë nr. 3, pa marrë ndihmë mjekësore. Sipas saj, familja u njoftua për ngjarjen rreth dy orë pas lëndimit të tij, ndërsa iu desh edhe afro një orë për të mbërritur në komisariat, për shkak të trafikut dhe situatës së krijuar në Tiranë.

Sipas motrës, mjekët i kanë thënë familjes se i riu e ka kaluar rrezikun për jetën, por ka pësuar frakturë në vertebrën e tretë dhe frakturë në kafkë. Ajo tha se ai ka gjithashtu edema, dëmtime të muskujve dhe shenja të shumta dhune. Sipas saj, megjithëse i riu mund të lëvizë gjymtyrët, dhimbjet nuk e lejojnë të ngrihet dhe të ecë.

Policia e Shtetit dhe Agjencia për Mbikëqyrjen e Policisë kanë njoftuar pezullimin e dy punonjësve të policisë në lidhje me këtë episod dhe nisjen e hetimeve për përcaktimin e përgjegjësisë ligjore.

Ish-drejtuesi i policisë, Shemsi Prençi, e cilësoi rastin si një nga episodet më të rënda të raportuara gjatë protestave. "Pamjet tregojnë shtatë punonjës policie që e rrethojnë dhe e godasin. Nuk mund të pezullohen vetëm dy prej tyre. Pse duhet të dhunohet? Neutralizoje, shoqëroje në automjet dhe largoje. Ka protokolle të qarta për këto raste", tha Prençi për REL-in.

Ai shtoi se, sipas vlerësimit të tij, në raste të tjera protestues të rrëzuar në tokë janë goditur me shkopinj gome ose shkelma.

Rasti i 21-vjeçarit është një nga 32 rastet që Qendra Res Publica thotë se ka dokumentuar gjatë ditëve të para të protestës. Organizata, e cila punon në fushën e të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës, ka kërkuar hetimin e rasteve dhe përcaktimin e përgjegjësive.

Gazi lotsjellës dhe plumbat e gomës nën shqyrtim

Dorian Matlija, drejtues i Qendrës Res Publica, tha për REL-in se organizata ka dokumentuar raste që, sipas saj, ngrenë dyshime për përdorim të pajustifikuar të forcës. "Është e pajustifikuar. Ushtrohet dhunë ndaj qytetarëve për të cilët nuk është e qartë nëse po kryejnë një veprim të dhunshëm, ose që janë neutralizuar, pra, persona që ndodhen të rrëzuar në tokë apo në duart e policisë, që goditen me shkopinj dhe shkelma. Këtu përfshihen edhe të miturit. Kemi të bëjmë me trajtime çnjerëzore gjatë kapjes dhe shoqërimit në polici", tha Matlija.

Sipas udhëzimeve të Kombeve të Bashkuara për përdorimin e forcës nga policia, ajo duhet të ushtrohet vetëm kur është e domosdoshme dhe në përpjesëtim me rrezikun. Forca nuk duhet të përdoret si ndëshkim dhe përdorimi i saj duhet të ndërpritet sapo të mos jetë më i nevojshëm.

Edhe Prençi tha se, sipas vlerësimit të tij, gjatë protestave janë shoqëruar persona që nuk ishin përfshirë në akte dhune.

Prençi vuri në pikëpyetje proporcionalitetin e forcës së përdorur, duke argumentuar se policia ishte e pajisur me helmeta, mburoja dhe shkopinj, ndërsa protestuesit nuk kishin pajisje të ngjashme mbrojtëse.

Përdorimi i gazit lotsjellës është një tjetër çështje që ekspertët kërkojnë të verifikohet. "Ka përdorim disproporcional të gazit lotsjellës, i cili nuk kursen as qytetarët e zakonshëm, madje as personat që ndodhen brenda lokaleve apo banesave", tha Matlija për REL-in.

Policë pa shenja identifikuese

Policët me rroba civile, të maskuar ose pa shenja identifikuese janë një tjetër çështje e ngritur nga ekspertët që kanë shqyrtuar ndërhyrjet policore gjatë protestave. Edhe ekipet e Avokatit të Popullit evidentuan punonjës policie pa numra identifikues në komisariatet nr. 2 dhe 4 gjatë monitorimit të 19 tetorit.

REL-i pyeti Policinë e Shtetit rreth këtij pretendimi, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk mori përgjigje.

Matlija tha se raportimi i rasteve të ngjashme edhe jashtë Tiranës ngre pyetje që duhen shqyrtuar në nivel institucional, përfshirë mënyrën e organizimit të ndërhyrjeve dhe përgjegjësinë e zinxhirit komandues. Ai tha se mungesa e identifikimit mund t'ua vështirësojë qytetarëve paraqitjen e ankesave dhe organeve kompetente përcaktimin e përgjegjësive. Sipas tij, Res Publica po shqyrton mundësinë e paraqitjes së një kallëzimi penal, duke përmendur hipotezën se mungesa e identifikimit mund të ketë krijuar kushte për shmangien e përgjegjësisë.

RENEA në protesta: Çfarë e justifikoi ndërhyrjen?

Tri ditë pas nisjes së protestave, forcat e RENEA-s, njësia speciale e Policisë së Shtetit për ndërhyrje në situata me rrezik të lartë, dolën në terren. Detyrat e kësaj njësie përfshijnë operacione të posaçme kundër personave të armatosur dhe të rrezikshëm, lirimin e pengjeve dhe ndërhyrjet në situata që kërkojnë kapacitete të specializuara.

Albert Nushi nga Departamenti i Sigurisë Publike tha se vendimi për angazhimin e RENEA-s u mor për të mbrojtur jetën e punonjësve të policisë. Sipas tij, në sallën operative kishte mbërritur një telefonatë ku raportohej se mes protestuesve kishte persona të armatosur dhe se po qëllohej me armë zjarri, në një kohë kur policia po sulmohej me lëndë piroteknike.

Ekspertë të intervistuar nga REL-i kanë vënë në pikëpyetje domosdoshmërinë e angazhimit të kësaj njësie në protestat e raportuara, duke argumentuar se nuk kanë parë prova publike për praninë e armëve luftarake në turmë.

Prençi tha se përdorimi i RENEA-s duhet të lidhet me natyrën e rrezikut dhe me detyrat e specializuara të kësaj njësie.

Të dielën kryeministri Rama tha se ishte neutralizuar një dron me eksploziv që, sipas tij, synonte të godiste Kryeministrinë.

Për këtë pretendim nuk janë bërë publike prova që do të mundësonin verifikimin e pavarur të tij. Mbetet gjithashtu e paqartë nëse për këtë rast ka nisur ndonjë hetim. Policia e Shtetit nuk iu përgjigj kërkesës së Radios Evropa e Lirë për konfirmim dhe sqarime.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

SEANCA E KËSHILLIT TË SIGURIMIT PËR KOSOVËN, ÇFARË THANË KONJUFCA, PËRFAQËSUESJA E SHBA-së DHE E MBRETËRISË SË BASHKUAR?

PRISHTINË, 21 TETOR - Të martën është mbajtur seanca e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Kosovën, ku është diskutuar lidhur me zhvillimet në vend dhe raportin gjashtëmujor të shefit të UNMIK-ut, Peter Due.

Në këtë seancë kanë paraqitur qëndrimet e tyre zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës i Kosovës, Glauk Konjufca, ministri i Jashtëm i Serbisë, Marko Gjuriq. Po ashtu, janë deklaruar përfaqësuesi i ShBA-së, ai i Britanisë së Madhe, i Bashkimit Evropian, etj.

Konjufca foli për aktgjykimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së, sulmin në Banjskë dhe kërcënimet e Serbisë

Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës, Glauk Konjufca, gjatë fjalimit të tij në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) ka folur për aktgjykimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së, sulmin në Banjskë dhe kërcënimet e Serbisë. Ai theksoi se aktgjykimi ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) përmban gabime faktike dhe përmbajtjesore.

Gjatë fjalës së tij në mbledhjen për Kosovën, Konjufca ka shprehur pritjen që këto gabime të korrigjohen gjatë procesit të apelit, duke theksuar rëndësinë e një procesi gjyqësor të paanshëm dhe të bazuar në fakte dhe prova. "Aktgjykimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së përmban gabime në fakte dhe në përmbajtje. Ne presim që këto gabime të korrigjohen në procesin e apelit. Drejtësia duhet të jetë e paanshme, të mbështetet në fakte dhe prova dhe të garantojë një proces të drejtë për të gjithë", është shprehur Konjufca.

Ministri Konjufca më tej ka kritikuar raportin e UNMIK-ut për zhvillimet në Kosovë, duke e cilësuar atë selektiv dhe duke pretenduar se një pjesë e rasteve të përfshira mbështeten në propagandën serbe.

Pjesën kryesore të kritikave ndaj raportit të UNMIK-ut, Konjufca ia ka kushtuar trajtimit të situatës së sigurisë, incidenteve në veri dhe sulmit të armatosur në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator 2023.

Duke folur për situatën në veri të Kosovës, ministri ka deklaruar se masat e qeverisë për promovimin e paqes, sigurisë dhe prosperitetit po japin rezultate. Sipas tij, mbyllja e strukturave që i ka cilësuar si ilegale dhe të operuara nga Serbia synon forcimin e institucioneve demokratike dhe garantimin e sigurisë juridike për të gjithë qytetarët. "Ne kemi mbyllur strukturat ilegale të operuara nga Serbia, të cilat synojnë ta parandalojnë integrimin etnik dhe t'i minojnë institucionet tona demokratike. Mbyllja e strukturave ilegale siguron siguri më të madhe juridike, trajtim të drejtë dhe siguri për çdo bashkësi etnike", ka thënë ai.

Konjufca ka theksuar se Policia e Kosovës, në bashkëpunim me KFOR-in dhe EULEX-in, vazhdon të angazhohet për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Ai ka përmendur gjithashtu hapjen e zyrave për çështje kadastrale, regjistrim të bizneseve, pensione, punësim, energji elektrike dhe administratë tatimore në komunat veriore.

Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës, Glauk Konjufca, ka folur edhe për kërcënimet e Serbisë ndaj Kosovës, duke theksuar synimet e saj ekspansioniste territoriale. Ai theksoi se zyrtarët serbë po e sfidojnë hapur Kosovën.

Konjufca në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara tha se personat që kanë kryer krime në Kosovë po vazhdojnë të jetojnë të lirë. "Zonja presidente, shteti i Serbisë, me flamurin e Serbisë, ka vrarë në vendin tim 12 000 njerëz të paarmatosur, të pafajshëm, shqiptarë. Asnjë fjalë nga ministri Gjuriq për 12 000 shqiptarë të vrarë. Këtë e quaj unë mohim të drejtësisë", tha Konjufca.

Gjatë fjalimit Konjufca ka folur edhe për gjendjen e shqiptarëve në Luginën e Preshevës, duke pretenduar se ata përballen me diskriminim sistematik dhe përjashtim nga sektori publik. Ai ka thënë se shqiptarët përbëjnë 71 për qind të popullsisë së

kombinuar të këtij rajoni, sipas regjistrimit të popullsisë në Serbi më 2022, por se përfaqësimi i tyre institucional mbetet i ulët.

Konjufca ka krahasuar këtë situatë me Kosovën ku, sipas tij, 20 nga 120 ulëset në Kuvend janë të garantuara për komunitetet joshumicë, përfshirë dhjetë ulëse për komunitetin serb.

Ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Marko Gjuriq, është ankuar për atë që e ka përshkruar si jetë jonormale dhe nën presion të serbëve që jetojnë në veri të Kosovës gjatë mbledhjes së Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) të martën.

Duke folur për aktgjykimin dënues ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nga Gjykata Speciale në Hagë, Gjuriq ka kritikuar Kosovën dhe Shqipërinë për reagimet kundër gjykatës. Ai ka bërë thirrje për, siç është shprehur, "guxim për t'u ballafaquar me të vërtetën", duke iu referuar viktimave të luftës në Kosovë.

Gjuriqi ka folur edhe për personat e zhdukur me dhunë gjatë luftës, duke thënë se zbardhja e fatit të tyre "nuk mund të varet nga negociatat politike". Megjithatë, 1 577 persona vazhdojnë të figurojnë të zhdukur nga lufta në Kosovë. Autoritetet e Kosovës i kanë kërkuar vazhdimisht Serbisë bashkëpunim për zbardhjen e fatit të tyre si dhe qasje në arkivat ushtarake që mund të ndihmojnë në identifikimin e lokacioneve të varreve të mundshme.

Zëvendëspërfaqësuesja e misionit amerikan në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), Tammy Bruce, gjatë deklaratës së saj në OKB ka dhënë një deklaratë të fortë, duke kërkuar mbylljen e UNMIK-ut.

Në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit, Bruce u bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë të ndërmarrin hapa konkretë për ndërtimin e besimit dhe të angazhohen në mënyrë konstruktive në dialog. Ajo theksoi se përparimi afatgjatë duhet të vijë nga vetë Kosova dhe Serbia.

Bruce kërkoi gjithashtu mbylljen e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), duke argumentuar se mandati i tij nuk i përgjigjet më realitetit aktual në vend. "Ne vëzhgojmë me një mision të tejkaluar. Nuk mund të pretendojmë se misioni ka ndonjë rol të konsiderueshëm në qeverisjen e Kosovës", tha Bruce.

Ajo e cilësoi UNMIK-un si një mision me shumë staf, por pa paqeruajtës, duke vlerësuar se vazhdimi i tij, pasi e ka përfunduar punën, nuk i ndihmon askujt dhe mund t'i dëmtojë grupet e cenueshme. Bruce kritikoi edhe pamundësinë e Këshillit të Sigurimit për ta rishikuar mandatin e misionit, duke e cilësuar këtë si shenjë të mosfunksionimit të sistemit të OKB-së. "Paaftësia jonë për ta rishikuar mandatin e përhershëm të UNMIK-ut është një shenjë paralajmëruese serioze e mosfunksionimit të sistemit të OKB-së, është paaftësia jonë për të vepruar kur momenti e kërkon veprimin", deklaroi ajo.

Në përfundim, përfaqësuesja amerikane theksoi se Këshilli i Sigurimit duhet të zgjedhë mes vazhdimit të misionit dhe administrimit më të mirë të burimeve të Kombeve të Bashkuara. "Koha e këtij misioni ka përfunduar", përfundoi Bruce.

Gjatë fjalimit në OBK, përfaqësuesja e Britanisë në OKB, Jennifer MacNaughtan, i bëri thirrje Serbisë që personat përgjegjës për sulmin në Banjskë, përfshirë Milan Radoiçiqin, të dalin para drejtësisë.

Në diskutimin e saj në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfaqësuesja e Britanisë përmendi edhe vrasjen e rreshterit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, duke theksuar se kanë kaluar më shumë se tre vjet nga sulmi dhe Serbia nuk ka ndërmarrë asgjë. Ajo kërkoi që Serbia të ofrojë qasje në arkiva për të mundësuar përparim në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë.

Britania ka mirëpritur formimin e institucioneve të Kosovës dhe ka kërkuar nga shtetet që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e vendit që t'i bashkohen shumicës së shteteve njohëse.

Përfaqësuesja britanike ka theksuar se normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mbetet thelbësor për stabilitetin afatgjatë dhe të ardhmen evropiane të të dyja vendeve. Ajo u ka bërë thirrje palëve t'i zbatojnë marrëveshjet e arritura në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, përfshirë Marrëveshjen e Ohrit, si dhe zotimet për vetëmenaxhimin e komunitetit serb në Kosovë.

Bashkimi Evropian ka deklaruar se përfaqësuesja e lartë për politikë të jashtme dhe siguri, Kaja Kallas, është e gatshme të thërrasë një takim të nivelit të lartë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por për këtë nevojitet vullnet nga të dyja palët.

Kështu ka deklaruar përfaqësuesi i BE-së në Kombet e Bashkuara, Stavros Lamperinos, gjatë mbledhjes së Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Kosovën. Ai ka theksuar se normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mbetet një nga kushtet thelbësore për përparimin e të dyja vendeve drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

BE-ja mbështet luftën kundër dezinformimit të nxitur nga inteligjenca artificiale

PRISHTINË, 21 TETOR - Bashkimi Evropian (BE) ka mbështetur Institutin e Kosovës për Drejtësi dhe partnerët e tij rajonalë në organizimin e konferencës dyditore "Kur inteligjenca artificiale takohet me lajmet e rreme", e mbajtur në Prishtinë, me qëllim të forcimit të bashkëpunimit rajonal në luftën kundër dezinformimit.

Në konferencë morën pjesë gazetarë, përfaqësues të shoqërisë civile, politikëbërës dhe ekspertë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Rumania. E financuar përmes projektit FACT të BE-së, konferenca trajtoi çështje që lidhen me transparencën, llogaridhënien dhe Aktin e BE-së për Inteligjencën Artificiale.

Vëmendje e veçantë iu kushtua rolit të gazetarisë së pavarur, verifikimit të fakteve dhe edukimit medial në ndihmën ndaj qytetarëve për ta identifikuar manipulimin e informacionit dhe për të marrë vendime të informuara.

Sipas BE-së, që nga viti 1999 në Kosovë janë investuar 3.7 miliardë euro, ndërsa Bashkimi Evropian mbetet partneri kryesor i Kosovës dhe ofruesi më i madh i ndihmës financiare.

HAMZA JEP DORËHEQJE NGA POZITA E KRYETARIT TË PDK-së

- Nuk po largohem nga PDK-ja, por vetëm nga pozita e kryetarit

Bedri Hamza ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Në një konferencë për medie mbajtur të mërkurën, ai ka thënë se ky vendim i hapë rrugë një procesi të ri zgjedhor brenda PDK-së, përmes të cilit anëtarët do të vendosin për drejtimin e ardhshëm të partisë. Hamza ka theksuar se përgjegjësitë që ka marrë nga viti 2020, pas dërgimit në Hagë të ish-udhëheqësve të PDK-së, përfshirë kandidimin për kryetar të Mitrovicës, kandidimin tri herë radhazi për kryeministër dhe udhëheqjen e partisë, i ka marrë për shkak të përgjegjësisë ndaj PDK-së e Kosovës dhe jo nga ambiciet personale. Megjithatë, ai ka thënë se kjo nuk do të thotë se do të largohet nga PDK-ja. "Po largohem vetëm nga pozita e kryetarit, por jo edhe nga besimi në vlerat tona politike", është shprehur ai

Mal QORRAJ

Prishtinë, 21 tetor - Kryetari Bedri Hamza e ka njoftuar të mërkurën Kryesinë e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për dorëheqjen e parevokueshme nga udhëheqja e partisë.

Hamza tha se ky vendim i hapë rrugë një procesi të ri zgjedhor brenda PDK-së, përmes të cilit anëtarët do të vendosin për drejtimin e ardhshëm të partisë, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes më të madhe të të rinjve dhe mundësive që ata të marrin përgjegjësi.

Hamza pohoi se përgjegjësitë që ka marrë nga viti 2020, pas dërgimit në Hagë të ish-udhëheqësve të PDK-së, përfshirë kandidimin për kryetar të Mitrovicës, kandidimin tri herë radhazi për kryeministër dhe udhëheqjen e partisë, i ka marrë për shkak të përgjegjësisë ndaj PDK-së e Kosovës e jo nga ambiciet personale.

Ai tha se gjatë udhëheqjes së tij është përqendruar në ruajtjen e unitetit të partisë, strukturave të saj dhe besimit të anëtarëve e të votuesve. "Nuk po largohem nga PDK-ja. Po largohem vetëm nga pozita e kryetarit, por jo edhe nga besimi në vlerat tona politike. Derisa të kem jetë, do të jem votues besnik i Partisë Demokratike të Kosovës dhe anëtar i kësaj familjeje të madhe politike", u shpreh ai.

Hamza foli edhe për vendimin e Dhomave të Specializuara ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së, duke shprehur zhgënjimin e tij me padrejtësinë në Hagë dhe duke theksuar se përpjekjet për drejtësi, zbardhjen e së vërtetës dhe kthimin e tyre pranë familjeve dhe Kosovës do të vazhdojnë.

Në fund, Hamza falënderoi të gjithë anëtarët, strukturat dhe mbështetësit e PDK-së për besimin dhe përkrahjen e vazhdueshme.

Ai theksoi se interesimi i partisë dhe i vendit duhet të jetë gjithmonë mbi interesin personal. "Unë nuk e dua PDK-në vetëm për ta udhëhequr. E kam dashur dhe do ta dua edhe pa e udhëhequr", përfundoi Hamza.

Pas këtij vendimi kanë reaguar në rrjetet sociale bashkëpartiakët e tij, duke theksuar se Hamza i dha PDK-së dhe Kosovës një shembull lidershipi të mbështetur në atdhedashuri, profesionalizëm dhe vlera të larta morale e njerëzore. Sipas tyre, Hamza e mori drejtimin e PDK-së në një periudhë të vështirë politike, por arriti ta ruajë unitetin e saj dhe ta udhëheqë me dinjitet. "Sot, kur Bedri Hamza përmbylli angazhimin e tij si kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, dua ta falënderoj përzemërsisht dhe publikisht për përkushtimin dhe mirëkuptimin gjatë rrugëtimit tonë të përbashkët në këtë nivel bashkëpunimi. Bedri, ka qenë kënaqësi dhe nder të punojmë bashkë. Në një periudhë intensive, me tri palë zgjedhje nacionale në mes, maturia dhe besimi yt na kanë dhënë forcë për të ecur përpara.

Ti e more përgjegjësinë e kryetarit i shtyrë nga nevoja për t'i shërbyer partisë dhe Kosovës, jo për ambicieje personale. Në një kohë të vështirë, ky angazhim ishte edhe në shërbim të çlirimtarëve tanë në Hagë, për të cilët u angazhove me tërë qenien. Jam e bindur se kemi ende shumë punë të mira për të bërë së bashku për PDK-në dhe Kosovën", ka reaguar pas këtij vendimi sekretarja e përgjithshme e PDK-së, Vlora Çitaku.

ENERGJIA E SË ARDHMES: SA AFËR JANË QYTETARËT ME MUNDËSITË QË OFRON LIGJI?

Qendresa RAMA

Prishtinë, 21 tetor - Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), në bashkëpunim me Lëvizjen FOL, organizoi edicionin e radhës, me temën "Energjia e së ardhmes: Sa afër janë qytetarët me mundësitë që ofron ligji?", në librarinë "Dukagjini" në Prishtinë.

Diskutimi mblodhi ekspertë të sektorit të energjisë, përfaqësues të organizatave dhe qytetarë të interesuar për të diskutuar për mundësitë që ofron korniza ligjore në Kosovë, sa po arrijnë qytetarët t'i shfrytëzojnë ato dhe cilat janë sfidat që po e përcjellin tranzicionin energjetik.

Në panel morën pjesë Granit Restelica, inxhinier i lartë i Mekanikës në Fondin e Kosovës për Efiçiencë të Energjisë (FKEE); Fiona Bakija, koordinatore e projekteve dhe hulumtuese në Balkan Green Foundation (BGF); Liron Gjocaj, koordinator i projekteve dhe hulumtues i lartë në Institutin për Politika Zhvillimore (INDEP); dhe Laura Kryeziu, eksperte e energjisë dhe bashkëthemeluese e Rrjetit Gratë në Energji dhe Miniera (Women in Energy and Mining).

Një nga çështjet kryesore të diskutimit ishte dallimi ndërmjet mundësive që ofron korniza ligjore dhe asaj që po realizohet në praktikë.

Gjatë diskutimit u vlerësuan pozitivisht zhvillimet në bazën ligjore të sektorit të energjisë, por njëkohësisht u ngritën shqetësime për ritmin dhe efektivitetin e zbatimit të saj. U theksua se ekzistimi i ligjeve dhe mekanizmave mbështetës nuk është i mjaftueshëm nëse qytetarët nuk kanë informata të qarta, mbështetje të duhur dhe mundësi reale për t'i shfrytëzuar ato.

Në këtë drejtim, vëmendje iu kushtua programeve të subvencionimit për efiçiencë të energjisë, të cilat u diskutuan si shembuj pozitivë të mbështetjes konkrete për familjet.

U trajtuan përvojat me skemat e mëparshme të Fondit të Kosovës për Efiçiencë të Energjisë, që kanë mbuluar një pjesë të kostos së investimeve, si dhe bashkëpunimi me UNDP-në për një skemë të re, e cila gjatë diskutimit u paraqit si mundësi për financimin e plotë të investimeve për familjet përfituese. Megjithatë, u ngrit edhe çështja e qasjes në këto programe dhe nevoja që mbështetja të arrijë te familjet që kanë më së shumti nevojë, përfshirë ato që nuk kanë mundësi financiare për të investuar vetë.

Përveç mbështetjes financiare, mungesa e informimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve u shtua si një tjetër pengesë për shfrytëzimin e mundësive në sektorin e energjisë.

U theksua nevoja që qytetarët të kenë më shumë informata për të drejtat që ua ofron legjislacioni, programet ekzistuese të mbështetjes dhe përfitimet ekonomike që mund të sjellin investimet në efiçiencë dhe energji të ripërtërishme. Në këtë kontekst u diskutua edhe rëndësia e një angazhimi më të madh të institucioneve qeveritare, jo vetëm në zbatimin e politikave dhe programeve, por edhe në informimin dhe lehtësimin e qasjes së qytetarëve në to.

Një mundësi tjetër e trajtuar ishte përfshirja më aktive e qytetarëve në prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme.

Diskutimi u përqendrua te potenciali i instalimit të paneleve solare në kulmet e shtëpive dhe zhvillimi i komuniteteve energjetike, përmes të cilave qytetarët mund të përfshihen në prodhimin dhe shfrytëzimin e përbashkët të energjisë.

Në këtë drejtim u ngrit nevoja që Kosova të realizojë një vlerësim të fizibilitetit dhe kapaciteteve të mundshme për instalimin e paneleve solare në kulmet e ndërtesave të banimit.

Një vlerësim i tillë do të ndihmonte në identifikimin e mundësive për qytetarët që të bëhen vetëprodhues të energjisë elektrike, duke prodhuar energji për konsumin e tyre dhe duke e dërguar energjinë e tepërt në rrjet, sipas mekanizmave përkatës.

Diskutimi u zgjerua edhe te drejtimi që po merr sektori i energjisë në Kosovë dhe nevoja për një tranzicion energjetik të planifikuar me kujdes.

U theksua se kalimi nga burimet tradicionale drejt energjisë më të pastër nuk duhet të kufizohet vetëm në ndryshimin e burimeve të prodhimit, por duhet të marrë parasysh edhe ndikimin social dhe ekonomik. Në veçanti u ngrit nevoja për planifikimin e së ardhmes së punëtorëve të sektorit tradicional të energjisë, përmes programeve të aftësimit dhe rikualifikimit profesional.

Kjo do të mundësonte që punëtorët, të cilët kanë kaluar pjesën më të madhe të jetës profesionale në këtë sektor, të kenë mundësi të përshtaten me ndryshimet dhe të mos mbesin jashtë tregut të punës.

Një tjetër shqetësim i ngritur lidhej me zbatimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës dhe arritjen e objektivave të përcaktuara deri në vitin 2031.

Gjatë diskutimit u vlerësua se objektivat e vendosura janë ambicioze, ndërsa ritmi aktual i zbatimit të masave të parapara ngre dyshime serioze për mundësinë e realizimit të tyre brenda afateve. Në këtë drejtim u theksua rëndësia e përshpejtimit të zbatimit të strategjisë dhe e një angazhimi më të madh institucional për përmbushjen e objektivave të saj.

Nga diskutimi dolën disa çështje që kërkojnë vëmendje dhe veprime të mëtejshme: përmirësimi i zbatimit të kornizës ligjore dhe politikave energjetike, zgjerimi i informimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve, lehtësimi i qasjes në skemat e subvencionimit, vlerësimi i potencialit për prodhimin e energjisë solare nga qytetarët si dhe planifikimi i masave sociale dhe ekonomike që duhet ta shoqërojnë tranzicionin energjetik.

Po ashtu, u theksua nevoja për angazhim më të madh të institucioneve përgjegjëse në realizimin e objektivave të Strategjisë së Energjisë.

Në përfundim, diskutimi nxori në pah se zhvillimi i sektorit të energjisë nuk duhet të matet vetëm me miratimin e ligjeve, hartimin e strategjive apo realizimin e investimeve, por edhe me mundësitë dhe përfitimet konkrete që krijohen për qytetarët. Për ta arritur këtë, nevojitet një qasje që lidh zhvillimin e sektorit me nevojat e qytetarëve, përballueshmërinë ekonomike dhe një tranzicion të drejtë, që nuk lë pas punëtorët dhe komunitetet e prekura nga ndryshimet.

PËRFAQËSUESIT POLITIKË TË LUGINËS TAKOJNË NAIM TËRNAVËN NË PRAG TË ZGJEDHJEVE NË SERBI: SHQIPTARËT DUHET TË DALIN NË VOTIME

Prishtinë, 21 tetor - Kryetarja e Preshevës, Ardita Sinani, ka njoftuar se të mërkurën është takuar me kreun e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Naim Tërnava, së bashku me përfaqësues të tjerë shqiptarë të Luginës së Preshevës, në prag të zgjedhjeve parlamentare në Serbi, të cilat, sipas njoftimit, do të mbahen më 25 tetor.

Sinani ka bërë me dije se temë qendrore e takimit ka qenë pjesëmarrja e shqiptarëve në votime dhe rëndësia e përfaqësimit politik të Luginës së Preshevës.

Në një postim ajo ka falënderuar Tërnavën për pritjen dhe mbështetjen e vazhdueshme për shqiptarët e Luginës. "Uniteti dhe bashkëpunimi, vlera që na bashkojnë! Sot patëm nderin të pritemi nga Kryemyftiu i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim ef. Tërnava, në një atmosferë të ngrohtë e vëllazërore. Në qendër të takimit ishte rëndësia e unitetit politik dhe mbështetjes së Listës së Përbashkët Shqiptare në zgjedhjet parlamentare të 25 tetorit. Biseduam për thirrjen drejtuar të gjithë shqiptarëve që të marrin pjesë në votim dhe për rëndësinë e përfaqësimit politik të Luginës së Preshevës. Falënderojmë kryemyftiun për pritjen e përzemërt dhe mbështetjen e vazhdueshme për shqiptarët e Luginës", ka shkruar Sinani.

Kurti takohet me ambasadorët e BE-së, rikonfirmohet mbështetja për integrimin evropian të Kosovës

Prishtinë, 21 tetor - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, priti në takim shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian, atë të EULEX-it, ambasadorë të shteteve anëtare si dhe atë të Mbretërisë së Bashkuar.

Kryeministri Kurti pranoi urime për zgjedhjen e presidentes dhe kthimin e stabilitetit institucional, përkatësisht krijimin e kushteve për përqendrim të plotë në planin dhe prioritetet e qeverisë në mandatin e ri. Krahas diskutimeve për vazhdimin e bashkëpunimit dhe reformat, u rikonfirmua mbështetja për përparimin e Republikës së Kosovës në rrugën drejt integrimit në Bashkimit Evropian.

MPB-ja RIAFIRMON ANGAZHIMIN PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Prishtinë, 21 tetor - Në kuadër të fushatës ndërgjegjësuese kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës riafirmon përkushtimin e saj për parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni, mbrojtjen e viktimave dhe forcimin e mekanizmave institucionalë për identifikimin, referimin dhe trajtimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore.

Trafikimi i qenieve njerëzore përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut dhe të dinjitetit njerëzor. Viktimat përballen me forma të ndryshme shfrytëzimi, përfshirë punën e detyruar, shfrytëzimin seksual dhe lypjen e detyruar. Veçanërisht të rrezikuar janë fëmijët, të rinjtë dhe personat në rrethana të cenueshme, të cilët kanë nevojë për mbrojtje të veçantë dhe reagim të koordinuar institucional e shoqëror.

Ministria e Punëve të Brendshme ka njoftuar se ndjek një qasje strategjike në parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni, duke u përqendruar në identifikimin e hershëm të viktimave, mbrojtjen e tyre dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, me qëllim parandalimin e rasteve të trafikimit dhe luftimin efektiv të kësaj veprimtarie kriminale.

"Sipas Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, për trafikimin me qenie njerëzore në Kosovë, gjatë periudhës së raportimit institucionet kanë shënuar progres në disa fusha, përfshirë rritjen e financimit për ndihmën ndaj viktimave, realizimin e aktiviteteve parandaluese, si dhe dënimin e më shumë personave për trafikim. Gjatë vitit 2025, institucionet identifikuan 13 viktima të trafikimit, ndërsa në bashkëpunim me shoqërinë civile u ofrua ndihmë për 18 viktima. Brenda kësaj periudhe raportuese, në kuadër të angazhimit ndërinstitucional të mekanizmave të sigurisë dhe drejtësisë, janë arrestuar 274 të dyshuar dhe janë ngritur kallëzime penale ndaj 290 personave për veprat penale trafikim me njerëz, mundësim ose detyrim në prostitucion, marrje me prostitucion dhe vepra të tjera", thuhet në komunikatën e MPB-së. Sipas MPB-së, zhvillimi i teknologjisë dhe përdorimi i gjerë i internetit dhe rrjeteve sociale kanë krijuar mundësi të reja për rekrutimin dhe mashtrimin e viktimave të mundshme.

Në këtë drejtim, Ministria e Punëve të Brendshme po shton përpjekjet për vetëdijesimin dhe informimin e qytetarëve mbi shenjat paralajmëruese të trafikimit të qenieve njerëzore dhe mënyrat e identifikimit të hershëm të situatave të rrezikut. "Qytetarët duhet të tregojnë kujdes ndaj ofertave të dyshimta dhe të jenë vigjilentë ndaj situatave në të cilat personat mund të kontrollohen, kërcënohen, ushtrohet presion ndaj tyre ose detyrohen të punojnë kundër vullnetit të tyre.

Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe partnerët vendorë e ndërkombëtarë, Ministria e Punëve të Brendshme vazhdon angazhimin për zbatimin e masave parandaluese, identifikimin dhe referimin e viktimave dhe viktimave të mundshme, si dhe forcimin e mekanizmave të mbrojtjes dhe mbështetjes për ta", theksohet në komunikatë.

Në vazhdën e aktiviteteve në kuadër të fushatës për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të njerëzve, Ministria e Punëve të Brendshme do të vijojë informimin e qytetarëve përmes SMS rreth mënyrave të raportimit të trafikimit të njerëzve, organizimin e ligjëratave me nxënës dhe mësimdhënës në shkollat në nivel vendi dhe ndarjen e materialeve dhe mesazheve informuese për raportimin e rasteve të trafikimit me njerëz. "Parandalimi dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore kërkon angazhim të vazhdueshëm institucional dhe bashkëpunim të ngushtë me qytetarët. Raportimi me kohë i rasteve të dyshimta u mundëson institucioneve kompetente të ndërhyjnë dhe të parandalojnë shfrytëzimin e mëtejmë të personave në rrezik. Çdo raportim trajtohet me konfidencialitet, duke ruajtur të dhënat e raportuesve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Çdo informacion i dhënë me kohë mund të ndihmojë në identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave të mundshme, si dhe në parandalimin e shfrytëzimit të mëtejmë të tyre. Ministria e Punëve të Brendshme u bën thirrje të gjithë qytetarëve që të mos heshtin përballë dyshimeve për trafikim me qenie njerëzore, por t'i raportojnë ato tek institucionet kompetente. Vetëm përmes vigjilencës, solidaritetit dhe veprimit të përbashkët mund të kontribuojmë në parandalimin e këtij fenomeni dhe në mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të çdo individi", është bërë me dije në komunikatën e MPB-së.

Drejtoresha e BKK-së shkëmben përvoja me Bibliotekën e Akademisë së Shkencave të Hungarisë

Prishtinë, 21 tetor - Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" dhe Biblioteka Kombëtare Szechenyi e Hungarisë kanë nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit, me qëllim të forcimit të bashkëpunimit përmes projekteve të përbashkëta kulturore, shkëmbimit të stafit dhe trajnimeve profesionale në fushën e digjitalizimit.

Ky bashkëpunim u bë i mundur falë angazhimit të Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Hungari, Delfin Pllana, të cilin e falënderojmë për iniciativën dhe mbështetjen në realizimin e këtij bashkëpunimi dhe kësaj vizite.

Memorandumi u nënshkrua nga drejtoresha e përgjithshme e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, dr. Blerina Rogova Gaxha, dhe drejtoresha e përgjithshme e Bibliotekës Kombëtare Szechenyi, Judit Gerencser.

Në takim, përveç përfaqësuesve të dy institucioneve morën pjesë edhe sekretari i Ministrisë së Kulturës në Kosovë, Bislim Bislimi, si dhe përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme të Hungarisë.

Gjatë vizitës delegacioni pati mundësinë të njihet nga afër me punën e institucionit, shërbimet për përdoruesit, proceset e digjitalizimit, si dhe mënyrat e ruajtjes së koleksioneve bibliotekare.

Nënshkrimi i memorandumit shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit mes dy bibliotekave dhe zhvillimit të lidhjeve kulturore mes Kosovës dhe Hungarisë.

KOMISIONI PËR BUXHET NUK E MBËSHTET NDARJEN E NJË MILION EUROVE PËR PROTEZAT E INVALIDËVE TË LUFTËS, PESË DEPUTETË TË LV-SË ABSTENUAN

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 21 tetor - Komisioni për Buxhet nuk e ka mbështetur amendamentin për ndarjen e një milion eurove shtesë për pajisje, proteza dhe mjete të tjera mjekësore për invalidët e luftës, në kuadër të shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndarjet buxhetore për vitin 2026.

Amendamenti, i propozuar nga Komisioni për Mirëqenie Sociale, Punë, Familje, Vlerat e Luftës Çlirimtare, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Persona të Pagjetur, mori pesë vota për, asnjë kundër, ndërsa pesë anëtarë, deputetë të LV-së, abstenuan.

Ministri i Financave, Hekuran Murati, tha se çështja është e rregulluar përmes një udhëzimi administrativ të Ministrisë së Shëndetësisë, të miratuar në mars të vitit 2024, dhe se mbulimi i shpenzimeve bëhet përmes Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Kryetari i Komisionit për Buxhet, Enver Haliti, bëri me dije se, sipas informatave nga Ministria e Shëndetësisë, përmes dy vendimeve të veçanta të vitit 2024 kanë përfituar 103 persona, prej tyre 58 invalidë të luftës së UÇK-së dhe 45 invalidë civilë të luftës. Sipas tij, pothuajse të gjitha kërkesat për mbulimin e shpenzimeve të protezave janë zgjidhur, me përjashtim të një rasti që është ende në shqyrtim.

Megjithatë, deputetët Mërgim Lushtaku i PDK-së dhe Teuta Haxhiu e Aleancës e mbështetën amendamentin, duke thënë se invalidët e luftës vazhdojnë të përballen me vështirësi në sigurimin e protezave dhe mbulimin e shpenzimeve.

Edhe deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, e përkrahu amendamentin, por kërkoi që shpenzimet për protezat të përfshihen në buxhetin e rregullt të Klinikës së Ortopedisë në QKUK, në mënyrë që kjo çështje të zgjidhet në mënyrë të përhershme dhe të mos varet nga vendimet e veçanta të qeverisë apo ministrit të Shëndetësisë.

Në të njëjtën mbledhje, Komisioni diskutoi edhe ndryshimin e nenit 5 të projektligjit, që lidhet me kompensimin retroaktiv të përvojës së punës, në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Deputeti Mërgim Lushtaku kërkoi që formulimi që parasheh se qeveria "mund ta miratojë" pagesën e kompensimeve retroaktive të rishikohet, duke argumentuar se kompensimi duhet të jetë obligim.

Ministri Murati tha se formulimi synon ta krijojë bazën ligjore për kompensimin, duke shmangur mundësinë e tejkalimeve buxhetore.

Ndërkaq Avdullah Hoti kundërshtoi përdorimin e fjalës "mund", duke theksuar se zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese është obligim për qeverinë dhe jo çështje diskrecionale.

Edhe përfaqësuesja e Zyrës Ligjore të Kuvendit u shpreh se formulimi mund të rishikohet, duke e zëvendësuar shprehjen "mund të miratojë" me "miraton pagesën e kompensimit retroaktiv".

Haradinaj: E papranueshme, ata që dhanë gjymtyrët për lirinë e Kosovës, sot lihen në harresë nga qeveria Kurti

Ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se është e papranueshme që ata që dhanë gjymtyrët dhe shëndetin për lirinë e Kosovës, sot të lihen në harresë nga kjo qeveri. "Mosmbështetja e amendamentit për ndarjen e një milion eurove shtesë për proteza dhe pajisje mjekësore për invalidët e luftës është e dhimbshme dhe dëshmi e mungesës së kujdesit nga ana e pushtetit ndaj kësaj kategorie të shenjtë. Proteza për një invalid të luftës nuk është luks, por domosdoshmëri. Këto pajisje duhet të ndërrohen periodikisht, ndërsa kostoja e tyre është e papërballueshme për shumë prej tyre. Është detyrim i shtetit që t'ua sigurojë, e jo t'i lërë të kërkojnë ndihmë te miqtë dhe bashkatdhetarët në diasporë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

MINISTRIA E ARSIMIT VAZHDON MBËSHTETJEN PËR 54 QENDRA MËSIMORE QË MBËSHTESIN MBI 2 600 FËMIJË

Prishtinë, 21 tetor - Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka nënshkruar kontratat me 10 organizata përfituese të mbështetjes financiare për vitin 2026/2027, të cilat menaxhojnë 54 qendra mësimore që mbështesin mbi 2 600 fëmijë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, nga klasa e parë deri në klasën e nëntë.

Në ceremoninë e nënshkrimit të kontratave me organizata përfituese mori pjesë ministri i Arsimit dhe Shkencës, Hajrulla Çeku, bashkë me sekretarin e përgjithshëm të ministrisë, Naim Gashi.

Ministri përgëzoi organizatat përfituese për punën e deritanishme dhe u uroi shumë suksese në zbatimin e projekteve dhe programeve të tyre. Duke i falënderuar për bashkëpunimin, i ftoi ato që ta thellojnë edhe më tej partneritetin dhe angazhimin e përbashkët për përmirësimin e rezultateve të të nxënit, barazisë dhe rritjes së pjesëmarrjes së fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në arsim.

Mbështetja është ndarë në kuadër të thirrjes publike "Për ofrimin e mbështetjes financiare për projektet e OJQ-ve që mbështesin dhe promovojnë nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian në qendrat mësimore". Kjo skemë financimi për qendrat mësimore vazhdon të zbatohet që nga viti 2021 si një mekanizëm bashkëpunimi ndërmjet ministrisë dhe organizatave joqeveritare që menaxhojnë këto qendra.

Për vitin shkollor 2026/2027 mbështetja financiare ka shënuar rritje krahasuar me vitet paraprake. Për 10 organizata joqeveritare përfituese, është ndarë një shumë prej 370 000 eurosh, në krahasim me 250 000 euro sa ishin ndarë për vitin e kaluar shkollor.

Mbështetja financiare për vitin shkollor 2026/2027 mundëson vazhdimin e ofrimit të shërbimeve mbështetëse për nxënësit e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian përmes qendrave mësimore, në përputhje me prioritetet e ministrisë për avancimin e barazisë, përfshirjes dhe cilësisë në arsim.

ASK-ja organizon takimin ndërkombëtar Px - Meeting 2026

Prishtinë, 21 tetor - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) është mikpritëse e takimit ndërkombëtar Px - Meeting 2026 që zhvillohet më 21-22 tetor 2026.

Takimi bashkon përfaqësues të institucioneve statistikore dhe ekspertë për të shkëmbyer përvoja mbi publikimin digjital të statistikave zyrtare dhe përmirësimin e qasjes së publikut në të dhëna.

Për këtë takim janë regjistruar 126 pjesëmarrës, prej të cilëve 50 për pjesëmarrje fizike dhe 76 pjesëmarrës online.

Në listën e regjistrimit përfaqësohen rreth 35 shtete, ndër të tjera Suedia, Finlanda, Norvegjia, Danimarka, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Në fjalën e saj për hapjen e takimit, shefja e Kabinetit të kryeministrit të Republikës së Kosovës, Flora Macula, theksoi rëndësinë e statistikave të besueshme për vendimmarrjen dhe planifikim të shërbimeve publike. Ajo nënvizoi se të dhënat duhet të jenë të lehta për t'u gjetur, kuptuar dhe për t'u përdorur nga qytetarët, studiuesit, bizneset dhe institucionet.

Ndërkaq, drejtori ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, në fjalën e mirëseardhjes vë në pah përvojën rreth 15-vjeçare të Kosovës në përdorimin e PX-Web.

Programi dyditor përfshin zhvillimet në PxWeb 2, përmirësimet në ndërfaqet për qasje automatike në të dhëna (API), vizualizimin e statistikave dhe shkëmbimin e përvojave praktike nga institucionet pjesëmarrëse.

Ekspertë nga institucionet statistikore të vendeve nordike prezantojnë zgjidhje dhe plane për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre mjeteve. Për publikun këto zhvillime lidhen me mundësinë për t'i kërkuar dhe

krahasuar më lehtë statistikat sipas nevojave të tyre.

Portali ASKData që përdor Px-Web është një nga mjetet përmes të cilave ASK-ja i vë të dhënat zyrtare në dispozicion të përdoruesve.

ÇFARË U KUSHTON QYTETARËVE NGECJA E INVESTIMEVE KAPITALE?

Prishtinë, 21 tetor - Mungesa e çerdheve publike i detyron shumë prindër t'u drejtohen kopshteve private, duke shtuar shpenzimet familjare. Ky është një nga shembujt se si mosrealizimi i investimeve kapitale prek jetën e përditshme të qytetarëve, thotë Albulena Nrecaj nga organizata joqeveritare Iniciativa për Progres (INPO). "Unë jam nënë vetë dhe detyrohem që fëmijën tim ta dërgoj në kopsht privat, i cili edhe kushton, edhe nuk më ofron kushtet që do të duhej t'i ofronte një kopsht publik", thotë Nrecaj në podkastin "5 Pyetje" të Radios Evropa e Lirë.

Përtej shifrave buxhetore, sipas saj, pasojat shihen në qasjen në shërbime publike, në kohën e udhëtimit, në mundësitë për punësim dhe në shpenzimet familjare. "Qytetari humb shërbimin të cilin shteti duhet t'ia ofrojë", thotë ajo.

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2026, Qeveria e Kosovës shpenzoi vetëm 18 për qind të buxhetit të planifikuar për investime kapitale. "Fatkeqësisht, jo vetëm në këtë vit, por edhe në vitet e kaluara, ne kemi parë një cikël shumë të ulët të zhvillimit të projekteve të cilat kanë për qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve", thotë Nrecaj. Sipas saj, investimet kapitale kanë rëndësi edhe për ekonominë, pasi realizimi i tyre krijon punë për operatorët ekonomikë dhe mundëson qarkullimin e parasë në treg.

Nrecaj thotë se shpenzimet përmes prokurimit publik përbëjnë rreth 10 për qind të bruto produktit vendor të Kosovës, çka e bën këtë fushë të rëndësishme për aktivitetin ekonomik.

Kur projektet vonohen, sipas saj, edhe bizneset humbin mundësitë për të realizuar punë dhe për të shfrytëzuar kapacitetet e tyre.

Pse ngecin investimet kapitale?

Nrecaj thotë se realizimi i vetëm 18 për qind të buxhetit në gjysmën e parë të vitit ishte i pritshëm, pasi kishte pak projekte për të cilat ishin iniciuar procedurat për t'i realizuar.

Sipas saj, as kjo shumë nuk nënkupton domosdoshmërisht investime të reja, pasi përfshin edhe pagesa për detyrime ligjore në rastet që kanë përfunduar në procedurë përmbarimore.

Ndër problemet kryesore, ajo rendit planifikimin e mangët të projekteve, keqmenaxhimin e kontratave me operatorët ekonomikë që kryejnë punimet dhe vështirësitë me shpronësimet. "Ne nuk kemi mbikëqyrje adekuate", thekson ajo, duke përmendur rastin kur një menaxher kontratash në një institucion duhej të menaxhonte rreth 13 kontrata brenda një viti fiskal.

Sipas Nrecajt, përfaqësuesit politikë premtojnë projekte pa analizuar mirë sa janë të realizueshme ato. "U premtohet qytetarëve se do t'i ndërtojnë, e do t'ua zgjidhim çështjen e spitaleve, rrugëve, shkollave e të tjera, por pa e pasur parasysh aspektin e planifikimit dhe vështirësitë që mund të dalin në momentin kur e fusim atë projekt në buxhet", thotë ajo.

Shpronësimi, sipas saj, bëhet pengesë kur qytetarët mësojnë se një projekt do të shtrihet në pronat e tyre vetëm pasi ai është përfshirë në planin buxhetor të shtetit. "Njerëzit me shumë legjitimitet kërkojnë çmimin më të lartë për pronën e vet dhe në këtë kuptim shfaqen pengesa të tjera, ka edhe të tjerë që nuk dëshirojnë fare ta japin pronën e tyre".

Këto probleme, sipas Nrecajt, i zvarrisin projektet dhe ua vonojnë qytetarëve shërbimet që u janë premtuar.

Dita e Gruas Rurale, Muja: Vetëm 5 për qind e pronave në Kosovë janë në pronësi të grave

Prishtinë, 21 tetor - Në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë është organizuar panairi me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas Rurale, i organizuar nga EcoKosWomen dhe Shoqata e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës. Në këtë aktivitet u vu në pah roli dhe kontributi i grave rurale në bujqësi, blegtori, prodhimin dhe përpunimin e produkteve ushqimore si dhe në zhvillimin e bizneseve familjare.

Kryetari i Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit të Kosovës, Naser Bajraktari, tha se puna e grave rurale është e rëndësishme për zhvillimin ekonomik, por shpesh nuk vlerësohet sa duhet. "Gratë rurale kanë rol të pazëvendësueshëm jo vetëm në sektorin e prodhimit të qumështit dhe blegtorisë, por edhe në bujqësi, në përpunimin e produkteve ushqimore, në bizneset familjare dhe në shumë veprimtari të tjera që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik. E dimë se puna e tyre shpesh është e vështirë dhe nuk vlerësohet gjithmonë sa duhet. Prandaj, si Shoqatë e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës jemi të përkushtuar ta vazhdojmë mbështetjen për gratë rurale, duke promovuar punën e tyre dhe duke krijuar mundësi për fuqizimin dhe zhvillimin e tyre ekonomik", ka deklaruar Bajraktari.

Ndërsa ministri i Bujqësisë, Armend Muja, tha se 15 për qind e përfituesve në skemat e Ministrisë janë gra, ndërsa si një nga barrierat kryesore përmendi çështjen e pronës. "Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, 15 për qind e përfituesve në skemat tona janë gra. Por një nga problemet që ky komunitet ballafaqohet është prona. Siç e dimë, vetëm rreth 5 për qind e pronave në Kosovë janë në pronësi të grave. Kjo është barriera e parë strukturore të

cilën dëshirojmë ta tejkalojmë dhe nga viti tjetër ministria e Bujqësisë do të ndërmarrë masa afirmative që e vlerësojnë këtë si sfidën numër një", ka thënë ai.

Në anën tjetër, drejtoresha e Bujqësisë në komunën e Prishtinës, Jeta Rafuna, theksoi se gratë fermere janë shtyllë e rëndësishme e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik.

ASK-ja organizon takimin ndërkombëtar Px - Meeting 2026

Prishtinë, 21 tetor - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) është mikpritëse e takimit ndërkombëtar Px - Meeting 2026 që zhvillohet më 21-22 tetor 2026.

Takimi bashkon përfaqësues të institucioneve statistikore dhe ekspertë për të shkëmbyer përvoja mbi publikimin digjital të statistikave zyrtare dhe përmirësimin e qasjes së publikut në të dhëna.

Për këtë takim janë regjistruar 126 pjesëmarrës, prej të cilëve 50 për pjesëmarrje fizike dhe 76 pjesëmarrës online.

Në listën e regjistrimit përfaqësohen rreth 35 shtete, ndër të tjera Suedia, Finlanda, Norvegjia, Danimarka, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Në fjalën e saj për hapjen e takimit, shefja e Kabinetit të kryeministrit të Republikës së Kosovës, Flora Macula, theksoi rëndësinë e statistikave të besueshme për vendimmarrjen dhe planifikim të shërbimeve publike. Ajo nënvizoi se të dhënat duhet të jenë të lehta për t'u gjetur, kuptuar dhe për t'u përdorur nga qytetarët, studiuesit, bizneset dhe institucionet.

Ndërkaq, drejtori ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, në fjalën e mirëseardhjes vë në pah përvojën rreth 15-vjeçare të Kosovës në përdorimin e PX-Web.

Programi dyditor përfshin zhvillimet në PxWeb 2, përmirësimet në ndërfaqet për qasje automatike në të dhëna (API), vizualizimin e statistikave dhe shkëmbimin e përvojave praktike nga institucionet pjesëmarrëse.

Ekspertë nga institucionet statistikore të vendeve nordike prezantojnë zgjidhje dhe plane për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre mjeteve. Për publikun këto zhvillime lidhen me mundësinë për t'i kërkuar dhe

krahasuar më lehtë statistikat sipas nevojave të tyre.

Portali ASKData që përdor Px-Web është një nga mjetet përmes të cilave ASK-ja i vë të dhënat zyrtare në dispozicion të përdoruesve.

ÇFARË U KUSHTON QYTETARËVE NGECJA E INVESTIMEVE KAPITALE?

Prishtinë, 21 tetor - Mungesa e çerdheve publike i detyron shumë prindër t'u drejtohen kopshteve private, duke shtuar shpenzimet familjare. Ky është një nga shembujt se si mosrealizimi i investimeve kapitale prek jetën e përditshme të qytetarëve, thotë Albulena Nrecaj nga organizata joqeveritare Iniciativa për Progres (INPO). "Unë jam nënë vetë dhe detyrohem që fëmijën tim ta dërgoj në kopsht privat, i cili edhe kushton, edhe nuk më ofron kushtet që do të duhej t'i ofronte një kopsht publik", thotë Nrecaj në podkastin "5 Pyetje" të Radios Evropa e Lirë.

Përtej shifrave buxhetore, sipas saj, pasojat shihen në qasjen në shërbime publike, në kohën e udhëtimit, në mundësitë për punësim dhe në shpenzimet familjare. "Qytetari humb shërbimin të cilin shteti duhet t'ia ofrojë", thotë ajo.

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2026, Qeveria e Kosovës shpenzoi vetëm 18 për qind të buxhetit të planifikuar për investime kapitale. "Fatkeqësisht, jo vetëm në këtë vit, por edhe në vitet e kaluara, ne kemi parë një cikël shumë të ulët të zhvillimit të projekteve të cilat kanë për qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve", thotë Nrecaj. Sipas saj, investimet kapitale kanë rëndësi edhe për ekonominë, pasi realizimi i tyre krijon punë për operatorët ekonomikë dhe mundëson qarkullimin e parasë në treg.

Nrecaj thotë se shpenzimet përmes prokurimit publik përbëjnë rreth 10 për qind të bruto produktit vendor të Kosovës, çka e bën këtë fushë të rëndësishme për aktivitetin ekonomik.

Kur projektet vonohen, sipas saj, edhe bizneset humbin mundësitë për të realizuar punë dhe për të shfrytëzuar kapacitetet e tyre.

Pse ngecin investimet kapitale?

Nrecaj thotë se realizimi i vetëm 18 për qind të buxhetit në gjysmën e parë të vitit ishte i pritshëm, pasi kishte pak projekte për të cilat ishin iniciuar procedurat për t'i realizuar.

Sipas saj, as kjo shumë nuk nënkupton domosdoshmërisht investime të reja, pasi përfshin edhe pagesa për detyrime ligjore në rastet që kanë përfunduar në procedurë përmbarimore.

Ndër problemet kryesore, ajo rendit planifikimin e mangët të projekteve, keqmenaxhimin e kontratave me operatorët ekonomikë që kryejnë punimet dhe vështirësitë me shpronësimet. "Ne nuk kemi mbikëqyrje adekuate", thekson ajo, duke përmendur rastin kur një menaxher kontratash në një institucion duhej të menaxhonte rreth 13 kontrata brenda një viti fiskal.

Sipas Nrecajt, përfaqësuesit politikë premtojnë projekte pa analizuar mirë sa janë të realizueshme ato. "U premtohet qytetarëve se do t'i ndërtojnë, e do t'ua zgjidhim çështjen e spitaleve, rrugëve, shkollave e të tjera, por pa e pasur parasysh aspektin e planifikimit dhe vështirësitë që mund të dalin në momentin kur e fusim atë projekt në buxhet", thotë ajo.

Shpronësimi, sipas saj, bëhet pengesë kur qytetarët mësojnë se një projekt do të shtrihet në pronat e tyre vetëm pasi ai është përfshirë në planin buxhetor të shtetit. "Njerëzit me shumë legjitimitet kërkojnë çmimin më të lartë për pronën e vet dhe në këtë kuptim shfaqen pengesa të tjera, ka edhe të tjerë që nuk dëshirojnë fare ta japin pronën e tyre".

Këto probleme, sipas Nrecajt, i zvarrisin projektet dhe ua vonojnë qytetarëve shërbimet që u janë premtuar.

Dita e Gruas Rurale, Muja: Vetëm 5 për qind e pronave në Kosovë janë në pronësi të grave

Prishtinë, 21 tetor - Në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë është organizuar panairi me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas Rurale, i organizuar nga EcoKosWomen dhe Shoqata e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës. Në këtë aktivitet u vu në pah roli dhe kontributi i grave rurale në bujqësi, blegtori, prodhimin dhe përpunimin e produkteve ushqimore si dhe në zhvillimin e bizneseve familjare.

Kryetari i Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit të Kosovës, Naser Bajraktari, tha se puna e grave rurale është e rëndësishme për zhvillimin ekonomik, por shpesh nuk vlerësohet sa duhet. "Gratë rurale kanë rol të pazëvendësueshëm jo vetëm në sektorin e prodhimit të qumështit dhe blegtorisë, por edhe në bujqësi, në përpunimin e produkteve ushqimore, në bizneset familjare dhe në shumë veprimtari të tjera që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik. E dimë se puna e tyre shpesh është e vështirë dhe nuk vlerësohet gjithmonë sa duhet. Prandaj, si Shoqatë e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës jemi të përkushtuar ta vazhdojmë mbështetjen për gratë rurale, duke promovuar punën e tyre dhe duke krijuar mundësi për fuqizimin dhe zhvillimin e tyre ekonomik", ka deklaruar Bajraktari.

Ndërsa ministri i Bujqësisë, Armend Muja, tha se 15 për qind e përfituesve në skemat e Ministrisë janë gra, ndërsa si një nga barrierat kryesore përmendi çështjen e pronës. "Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, 15 për qind e përfituesve në skemat tona janë gra. Por një nga problemet që ky komunitet ballafaqohet është prona. Siç e dimë, vetëm rreth 5 për qind e pronave në Kosovë janë në pronësi të grave. Kjo është barriera e parë strukturore të

cilën dëshirojmë ta tejkalojmë dhe nga viti tjetër ministria e Bujqësisë do të ndërmarrë masa afirmative që e vlerësojnë këtë si sfidën numër një", ka thënë ai.

Në anën tjetër, drejtoresha e Bujqësisë në komunën e Prishtinës, Jeta Rafuna, theksoi se gratë fermere janë shtyllë e rëndësishme e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik.

ARMA E TYRE: MIRËSIA! VULLNETARËT E INTERNETIT QË E KTHEJNË MIRËSINË NË ARMË

Rrjetet sociale shpesh shihen si pasqyrë e mizorisë njerëzore. Një burrë krijoi në TikTok një ushtri prej 500 000 ndjekësish për ta ndryshuar këtë. Arma e tyre: mirësia.

Çdo ditë, Laura Tigeleiro, nga Staten Island i Nju-Jorkut, hapte TikTok-un dhe përballej me një det urrejtjeje. «Të gjithë talleshin me syrin tim», thotë ajo.

Tigeleiro vuan nga skleroza e shumëfishtë, një sëmundje autoimune që ka bërë që njëri prej syve të saj blu depërtues të anohet anash. «Doja vetëm të ndaja receta të shëndetshme dhe ndoshta të bëja disa miq», thotë ajo. «Por ata thoshin gjëra të tmerrshme. Më lëndonte vërtet.» Pastaj, marsin e kaluar, telefoni i saj u mbush papritur me njoftime dhe gjithçka ndryshoi.

Njëra nga videot e saj ishte bërë virale, duke marrë mbi 15 000 komente dashamirëse. «Nuk e kuptoja çfarë po ndodhte. Isha e shtangur», thotë Tigeleiro. Disa ditë më vonë e zbuloi: ajo ishte vënë në shënjestër të Kindness Mob — «Turmës së Mirësisë».

Kindness Mob është një kanal në TikTok i drejtuar nga Tyler Brickley, specialist i marketingut digjital nga Kansas City në SHBA, i cili e nisi projektin në vitin 2023. «Është një formë trollimi», thotë ai. Çdo ditë, Brickley i orienton gjysmë milioni ndjekësit e tij drejt dikujt që po bullizohet ose po lihet në harresë dhe u kërkon ta mbushin me komente dashamirëse. «Po i marrim mekanizmat e ngacmimit në internet», si koordinimi dhe anonimiteti, dhe po i përdorim për të bërë mirë. «Dhe duhet ta them: funksionon.»

Këtu ka diçka më interesante sesa thjesht njerëz që sillen mirë. Kur turma ndërhyn, bullizmi shpesh ndalet, ndonjëherë përgjithmonë. Ky është një shembull i asaj që studiuesit e quajnë «teoria e përhapjes shoqërore», sipas së cilës sjelljet pozitive ose negative kalojnë nga njëri person te tjetri si një virus. Studiues të shquar më thonë se lëvizja e Brickley-t tregon se si mund ta ndryshojmë drejtimin jo vetëm të një platforme interneti, por ndoshta edhe të një kulture të tërë.

Mirësia si mision

«Kjo lloj sjelljeje në internet është e mrekullueshme, por sigurisht që na duhet më shumë», thotë Nicholas Christakis, profesor i shkencave shoqërore dhe natyrore në Universitetin Yale. «Është e mundur që kjo Turmë e Mirësisë po u krijon njerëzve mundësinë të hedhin hapat e parë drejt kontributeve më domethënëse që do të na duhet të japim, nëse duam të ndreqim mangësitë e shoqërisë sonë.»

«Më 1 janar 2023, po mendoja për vrullin që marrin sjelljet», thotë Brickley. «Më duket sikur shumë prej njerëzve që lënë komente negative nuk i mendojnë vërtet ato që shkruajnë.» Ata thjesht ndjekin turmën.

«Në atë çast më lindi ideja», thotë Brickley. «Mendova: po sikur të hap një kanal, të mbledh dhjetë veta në një klub të vogël dhe ta mbushim hapësirën e komenteve me pozitivitet, që ta ndryshojmë balancën?»

Dhjetë ishte një synim modest. Sipas përllogaritjeve të Brickley-t, ai ka organizuar 350 ndërhyrje të tilla dhe videot e përzgjedhura marrin mesatarisht nga 1 000 komente. Postimet më të suksesshme marrin dhjetëra mijëra komente ose më shumë dhe tërheqin miliona shikime. Në një ndërhyrje të kohëve të fundit mori pjesë edhe personazhi i famshëm Paris Hilton.

Shpesh, pjesëtarët e turmës zbulojnë se u pëlqen shumë llogaria që po «sulmojnë» dhe vazhdojnë ta ndjekin. Kjo ua ndryshon jetën njerëzve.

Renee Penick, një gjyshe nga Ohajo në SHBA, thotë se ndodhej pranë shtratit të të shoqit në spital kur mbërriti Turma. Kjo i dha forcë në një çast krize dhe krijoi një komunitet të tërë rreth videove të saj. Nocturne, një muzikante nga pjesa veriore e shtetit të Nju-Jorkut, thotë se turma i solli aq shumë admirues të rinj, sa tani po përgatitet të nisë një turne.

Pasi Brickley e drejtoi ushtrinë e tij te Tigeleiro, ajo fitoi aq shumë ndjekës të rinj, sa TikTok-u filloi ta paguante. Ajo thotë se fitoi mjaftueshëm para për t'i blerë familjes një makinë të re, për të cilën kishin shumë nevojë.

«Ëndërroja një jetë më të mirë dhe Tyler-i ma dha atë mundësi», thotë Tigeleiro. «Ia detyroj të gjitha atij, por ai nuk do të ishte dakord me këtë.»

Ndërkohë, Brickley bën çmos që personat e përzgjedhur nga Turma e Mirësisë të mos e kuptojnë se çfarë po organizohet. «Nuk jemi ne në qendër të kësaj historie. Synimi është të heqim pengesën, t'i largojmë të gjitha ato komente plot urrejtje, që përmbajtja e atij personi të mund të dalë në pah.»

Dhembshuria që përhapet

Kur njerëzit më flasin për anën e errët, aq të njohur, të botës në internet, e përshkruajnë atë si një pasqyrë: një sistem që thjesht pasqyron mizorinë e natyrshme të shpirtit njerëzor.

Megjithatë, Christakis thotë se ky është një interpretim i gabuar i asaj që ndodh në rrjetet sociale. «Po, ne njerëzit kemi evoluar edhe me prirjen për të gënjyer, për t'u ndarë në fise, për të qenë të ligj dhe për të dëmtuar të tjerët», thotë ai. «Por po aq kemi evoluar për të qenë të mirë; për të shfaqur dashuri, miqësi e mirësi dhe për t'u mësuar të tjerëve.»

Siç argumenton Christakis në librin e tij Blueprint: The Evolutionary Origins of a Good Society, «Plani: Origjina evolucionare e një shoqërie të mirë», këto cilësi të mira duhet të peshojnë më shumë se të këqijat në gjendjen tonë të natyrshme. Përndryshe, njerëzit do të kishin mësuar të jetonin të izoluar, jo në shoqëri ku janë vazhdimisht në kontakt me njëri-tjetrin.

«Rrjetet sociale i shfrytëzojnë këto cilësi të lashta, miqësore dhe bashkëpunuese», thotë ai, si duke mundësuar anonimitetin, ashtu edhe përmes algoritmeve që nxjerrin në pah konfliktin dhe përplasjet për të shtuar ndërveprimet dhe për të na mbajtur me sytë te telefoni.

Me fjalë të tjera, Christakis thotë se puna e Turmës së Mirësisë po anashkalon ndikimin e mbrapshtë të rrjeteve sociale dhe po nxit një mënyrë më «të natyrshme» e më të këndshme ndërveprimi. Në fund të fundit, shumica e të rriturve nuk do të hynin pa të keq në shtëpinë e një të panjohuri për t'i fyer pamjen, siç bëjnë kaq shumë njerëz në komentet e një videoje.

Kjo mund të sjellë edhe një varg pasojash të tjera pozitive. «Ne kemi treguar përmes eksperimenteve se mund të krijohen këto zinxhirë mirësie», thotë Christakis për kërkimet e tij. «Ti sillesh mirë me Susie-n, Susie sillet mirë me Betty-n dhe Betty sillet mirë me Tommy-n. Pra, mënyra si Betty e trajton Tommy-n varet nga mënyra si ti e trajtove Susie-n, edhe pse as ti dhe as unë nuk kemi ndërvepruar ndonjëherë me Betty-n apo Tommy-n.»

Në një internet që mund të duket i mbushur me ligësi, Christakis thotë se Turma e Mirësisë ka gjetur një zgjidhje që mbështetet nga shkenca. Kur njerëzit ndalojnë së polemizuari me trollët dhe, në vend të kësaj, krijojnë lidhje me njëri-tjetrin, studimet tregojnë se trollët mund ta ndryshojnë sjelljen.

Megjithatë, dikush duhet ta mbajë barrën e organizimit të gjithë kësaj mirësie.

Rraskapitja nga mirësia

Në shtator të vitit 2025, numri i ndjekësve të Brickley-t u rrit menjëherë nga 30 000 në 200 000. «Ishte shumë emocionuese», thotë ai, por kjo pati edhe një kosto. «Një ditë po shikoja telefonin dhe mendova: thjesht nuk mund ta bëj më këtë.»

Projekti nuk sjell fitime të mëdha. TikTok-u i paguan llogaritë me shumë ndjekës, por Brickley thotë se në gusht fitoi vetëm 39 dollarë. Ajo që e shtyn përpara është ndjenja e përgjegjësisë personale.

Çdo ditë, përmes një formulari në faqen e internetit të Turmës së Mirësisë, ndjekësit propozojnë nga 20 deri në 100 persona që mund të përfitojnë nga ndërhyrjet e saj. Por vëmendja e publikut është e kufizuar dhe Brickley organizon vetëm një ndërhyrje në ditë.

«Kjo do të thotë se çdo ditë më trokasin në derë 20 njerëz», thotë Brickley, të gjithë duke vuajtur nga mizoria e qëllimshme e të tjerëve. «Dhe mua më duhet t'u them jo 19 prej tyre, ndërsa ditën tjetër vijnë edhe 20 të tjerë.» Në fund, barra u bë aq e rëndë, sa atij iu desh të bënte disa muaj pushim.

Për ta lehtësuar disi ngarkesën emocionale, Brickley-t iu desh ta ndryshonte mënyrën si e shihte projektin. Nuk mund ta ndihmonte drejtpërdrejt çdo njeri në nevojë, por turma mund të zgjidhte një person çdo ditë dhe ta kthente atë rast në një mësim për të tjerët. Ai organizoi gjithashtu disa vullnetarë për të ndarë punën logjistike.

«Kam dy dhjetëvjeçarë që e studioj profesionalisht kulturën e internetit dhe nisma si kjo kanë një jetëgjatësi shumë të kufizuar», thotë profesoresha Alice Marwick, drejtoreshë e kërkimit në Institutin Kërkimor Data & Society. «Zakonisht, personi që qëndron pas tyre rraskapitet brenda një ose dy vjetësh dhe nisma shuhet.»

Platformat e rrjeteve sociale mbajnë një përgjegjësi të madhe për sjelljen e përdoruesve, thotë Marwick, por nuk mund t'ua hedhësh fajin vetëm algoritmeve.

«Ajo që na duhet është një ndryshim më i gjerë i normave shoqërore për mënyrën si i trajtojmë njerëzit në internet», thotë ajo. «Më pëlqen ideja e përhapjes së sjelljeve që u bëjnë mirë të tjerëve në internet. Nëse kjo do të sjellë apo jo një ndryshim të ndjeshëm, mbetet për t'u parë.» / BBC.com – Bota.al

Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

"Dardanet" avancojnë në ranglistën e FIFA-s

Prishtinë, 21 tetor - Kombëtarja e Kosovës në futboll në konkurrencën e femrave ka avancuar për dy pozita në ranglistën e FIFA-s. Në renditjen e fundit të publikuar nga FIFA, Kosova pozicionohet në vendin e 83-të, duke shënuar përparim me dy pozita krahasuar me renditjen paraprake. Së fundmi, "Dardanet" kanë pësuar dy humbje në ndeshjet gjysmëfinale të "play-off"-it kualifikues për Kupën e Botës ndaj Austrisë. Megjithatë, ato kanë avancuar në ranglistën e re. Ndërkohë, Kombëtarja e Shqipërisë ka humbur një pozitë në renditjen e FIFA-s. Shqipëria tani renditet në vendin e 68, pasi në klasifikimin e mëparshëm ishte në vendin e 67. Në krye të ranglistës së futbollit të femrave vazhdon të jetë Spanja, e ndjekur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Gjermania.

SOT NIS KUPA E BOTËS U15 NË AZERBAJXHAN, KOSOVA MUND TË PËRBALLET ME SERBINË

Baku, 21 tetor - Kupa e Botës FIFA U15 nis sot (e enjte) në Baku të Azerbajxhanit, me pjesëmarrjen e 189 ekipeve kombëtare të të rinjve nga e gjithë bota. Përveç rikthimit të Rusisë në një turne global të futbollit, vëmendje të veçantë kanë marrë edhe përballjet e mundshme mes vendeve me konflikte politike, përfshirë Kosovën dhe Serbinë.

Sipas mediumit gjerman "Sportschau", turneu organizohet për herë të parë në këtë format dhe do të zgjasë nëntë ditë, me rreth 1 000 ndeshje të planifikuara në 20 fusha. Ekipet do të garojnë fillimisht në 32 grupe, ndërsa rezultatet do ta përcaktojnë ndarjen e tyre në gjashtë nivele në fazën e dytë, ku secili nivel do ta ketë fituesin e vet. Pjesëmarrja e Rusisë është një nga temat më të diskutuara, pasi ky është turneu i parë global i futbollit ku ajo merr pjesë që nga nisja e luftës kundër Ukrainës.

Federata Ukrainase e Futbollit i ka thënë "Sportschau" se ishte tërhequr nga turneu për arsye sportive, përpara se të mësonte për pjesëmarrjen e Rusisë. Sipas saj, pas informimit të federatave të tjera, disa shtete vendosën të mos merrnin pjesë, ndërsa të tjera shprehën gatishmërinë për të garuar, por jo për t'u përballur me Rusinë.

Edhe Federata Gjermane e Futbollit (DFB) nuk do të dërgojë ekip në këtë turne. Për "Sportschau", ajo ka përmendur arsye që lidhen me zhvillimin e futbollistëve të rinj, duke argumentuar se talentet nuk duhet të ekspozohen shumë herët ndaj presionit për rezultate, vlerësimit publik dhe interesimit të agjentëve.

Vëmendja te Kosova dhe Serbia

Përtej aspektit sportiv, një nga temat më të ndjeshme të turneut është mundësia e përballjeve mes vendeve që kanë raporte të tensionuara politike. Sipas "Sportschau", rregulloret e plota të garës nuk janë publikuar, ndërsa FIFA ka bërë me dije se ndeshjet e fazës pas grupeve do të përcaktohen në bazë të rezultateve të fazës së parë,

pa kufizime të veçanta për kundërshtarët. Kjo e hap mundësinë teorike që Kosova të përballet me Serbinë, dy përfaqësuese që nuk lejohen të luajnë kundër njëra-tjetrës në garat e UEFA-s. Një duel i tillë do të kishte ndjeshmëri të veçantë politike dhe sportive, por deri më tani nuk është caktuar asnjë përballje mes tyre. Sipas mediumit gjerman, skenarë të ngjashëm mund të paraqiten edhe mes Izraelit dhe Palestinës, Iranit dhe Izraelit, si dhe Spanjës dhe Gjibraltarit. Këto janë mundësi teorike që varen nga rezultatet dhe rrugëtimi i ekipeve në turne.

Drejtori i zhvillimit global të futbollit në FIFA, Arsene Wenger, e ka përshkruar turneun si një mundësi për t'i bashkuar të rinjtë nga e gjithë bota. "Kjo është bukuria e këtij turneu. Ishte një ëndërr të kishim të gjithë nga e gjithë bota së bashku. Në FIFA ne gjithmonë themi se futbolli bashkon botën", ka deklaruar Wenger në një video të publikuar nga Organizata Botërore e Futbollit.

Edhe presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, e ka mbrojtur idenë e përfshirjes së sa më shumë vendeve në garat ndërkombëtare. Në lidhje me Rusinë ai kishte deklaruar në shkurt: "Sa më shpejt që të gjithë të përfshihen në një Kupë Bote, aq më mirë".

Turneu zhvillohet në Baku, kryeqytetin e Azerbajxhanit, një vend që prej vitesh ka raporte të tensionuara me Armeninë. Sipas "Sportschau", organizatat për të drejtat e njeriut i kanë kritikuar vazhdimisht autoritetet azerbajxhanase për përdorimin e ngjarjeve të mëdha sportive për ta rritur profilin ndërkombëtar të vendit. Kështu, përveç synimit për t'u dhënë futbollistëve të rinj përvojë ndërkombëtare, Kupa e Botës U15 pritet të tërheqë vëmendje edhe për shkak të përballjeve të mundshme mes vendeve me histori konfliktesh. Për Kosovën, një ndeshje ndaj Serbisë do të ishte një nga skenarët më të ndjeshëm të kësaj gare.

Kuka kritikon natyralizimin e sportistëve: Kosova ka fëmijë të talentuar

Prishtinë, 21 tetor - Trajneri i njohur i xhudos, Driton Kuka, ka kritikuar praktikën e natyralizimit të sportistëve në Kosovë, duke kërkuar përcaktimin e kritereve të qarta dhe hartimin e një strategjie afatgjatë për zhvillimin e sportit dhe talentëve të rinj.

Në një reagim publik, Kuka ka thënë se mungesa e rezultateve në sportin vendor po krijon situata shqetësuese për gjeneratat e reja. Ai ka ngritur shqetësime edhe për natyralizimin e fëmijëve, duke theksuar se kjo praktikë nuk duhet të shndërrohet në strategji të ministrisë përgjegjëse për sportin apo të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK). "E kuptoj që ka dhe do të ketë natyralizime dhe kjo do të duhej të bëhej me kritere shumë të qarta. Nëse një sport ka nivel dhe një sportist shihet si përforcim i ekipit, jemi në rregull, por jo ndryshe", ka shkruar Kuka në rrjetet sociale.

Ai ka theksuar se Kosova ka shumë sportistë të talentuar, të cilët kanë dështuar se vendi mund të nxjerrë garues të nivelit të lartë pa u mbështetur te natyralizimet.

"Kosova ka fëmijë të mirë dhe Majlinda, Nora, Distria, Donjeta, Akili e shumë të tjerë e kanë dështuar", ka shkruar trajneri Kuka.

Kuka ka kërkuar gjithashtu krijimin e Këshillit Kombëtar të Sportit, përmes të cilit do të përcaktoheshin prioritetet dhe do të hartohej një strategji e qartë për zhvillimin e sportit në Kosovë. Ai është shprehur i bindur se vendi ka potencial për të nxjerrë kampionë dhe për të fituar medalje në garat më të rëndësishme ndërkombëtare.

"Koha të kemi Këshillin Kombëtar të Sportit e të shohim çka është prioritet dhe të kemi strategji të qartë! Kosova di dhe mund të ndërtojë medalje të arta evropiane, botërore e olimpike!", ka shkruar Kuka.

Në fund të reagimit trajneri ka rikujtuar sukseset olimpike të xhudos së Kosovës, duke vënë në pah kontributin e Pejës në përgatitjen e kampioneve olimpike.

"Tri të artat olimpike janë ndërtuar në Pejën e bukur me vajzat e lindura e të rritura në luftën tonë çlirimtare dhe të tria këto medalje flasin shqip", ka shkruar Kuka.

F2.3/BNJ-KPDS/PT

"PASTRIMI" SH.A
Nr. 06/03/7482
Di. 21-10-2026

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

